



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM
Nr. 61 datë 30.09.2024

**“PËR MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË
DHE TË NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË PËR VITIN 2024”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 30.09.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 8, nenit 24, të ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, të nenit 38 të ligjit Nr. 22/2018 “Për Strehimin Social, i ndryshuar, pika 4/a e VKM-së Nr. 362, datë 29.05.2019 “Kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij ,dhe sipas relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër,

V E N D O S I:

1. Miratimin e nivelit të qirasë mesatare mujore në treg të lirë sipas strukturave të apartamenteve në zonat urbane dhe ato rurale në territorin e Bashkisë Shkodër, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi mesatar në zonat urbane (lekë pa tvsh)	Çmimi mesatar në zonat rurale (lekë pa tvsh)
1	Banesa me qira (Apartament tip garsonierë)	muaj	1	19,250	10,300
2	Banesa me qira (Apartament 1 + 1)	muaj	1	26,200	14,300
3	Banesa me qira (Apartament 2 + 1)	muaj	1	34,300	18,300
4	Banesa me qira (Apartament 3 + 1)	muaj	1	47,000	25,000

2. Vlera maksimale e subvencionit të qirasë është e barasvlefshme me qiratë mesatare në tregun e lirë sipas vlerave të paraqitura në këtë projekt-vendim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 39 vota
Vota Pro 39
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 01.10.2024

SEKRETARE

Sabina Danaj

KRYETAR

Oltion LULLI

